


Udhëzues përdorimi mbi mënyrën e përdorimit të shërbimit “Rivendosje Fjalëkalimi për tatimpagues të regjistruar”


Aplikimi për Rivendosje të fjalëkalimit të deklarimit elektronik kryhet nga tatimpagues apo individët të cilët janë aktualisht të regjistruar.

Mënyra e parë: Rivendosje fjalëkalimi nëpërmjet e-filing

Hapi 1: Në e-filing, pra në menunë e-shërbime të www.tatime.gov.al, klikoni linkun e-Albania Login



Hapi 2: Pasi të keni klikuar linkun e mësipërm, do të ridrejtoheni në portalin e-albania. **Vendosni kredencialet tuaja të llogarisë në e-Albania (NIPT/ID dhe Fjalëkalim), dhe klikoni butonin Hyr**



Hapi 3:

Pas vendosjes së kredencialeve (NIPT dhe Fjalëkalim) do të dërgoheni automatikisht në llogarinë tuaj në e-Filing



Hapi 4:

Klikoni menunë me emërtimin **Menaxhimi i Aksesit** -> **Ndrysho Fjalëkalimin**

The screenshot shows the E-Tax Shqipëri website interface. At the top, there is a navigation bar with the logo of the Directorate of Tax Administration and several menu items: Deklarata, Listëpagesat, Librat e Shitjeve dhe Blerjeve, Kontabilitet, eFiling Im, **Menaxhimi i Aksesit**, and Rreth eFiling. The 'Menaxhimi i Aksesit' menu is expanded, showing options: Përdoruesit e Mi, **Ndrysho Fjalëkalimin**, Përfaqësuesit e Mi, and Tatimpaguesit e Mi. Below the navigation bar, there is a section titled 'Mirëseerdhët në e-Filing' and a list of browser versions supported: Internet Explorer nga versioni 10, Mozilla Firefox nga versioni 25, and Google Chrome nga versioni 30. A note at the bottom states: 'Kujdes: Kur përdorni Internet Explorer-in sigurohuni që pamja e përshfaqjes është fikur.'

Hapi 5:

Pasi të keni klikuar menunë e mësipërme, do t'ju shfaqet forma përkatëse për ndryshimin e fjalëkalimit dhe do të keni mundësinë të kryeni ndryshimet

The screenshot shows the 'Ndrysho Fjalëkalimin' form on the E-Tax Shqipëri website. The form includes a title 'Ndrysho Fjalëkalimin', a field for 'Fjalëkalim i Ri *', a field for 'Konfirmo Fjalëkalimin *', and a 'Ruaj' button. A blue box contains instructions: 'Fjalëkalimi duhet të plotësojë kushtet më poshtë: 1. Duhet të jetë të paktën 8 karaktere i gjatë. 2. Duhet të përmbajë të paktën një numër. 3. Duhet të përmbajë të paktën një gërmë kapitale dhe një jo-kapitale.'

Mënyra e dytë: Rivendosje fjalëkalimi nëpërmjet e-filing

Hapi 1: Vendosni kredencialet tuaja në e-Albania si qytetar/biznes (NIPT/ID dhe Fjalëkalim)

The screenshot shows the e-Albania website login page. At the top, there is a logo with the letter 'e' and the word 'albania' below it, and the date 'e enjte, 16 korrik 2020'. The main heading is 'Identifikimi'. Below this, there are two input fields: 'Numri personal/NUIS' and 'Vendosni fjalëkalimin'. There is a link that says 'Keni harruar fjalëkalimin tuaj?' and a red button labeled 'Hyr'.

Hapi 2: Zgjidhni shërbimin Rivendosje Fjalëkalimi për tatimpagues të regjistruar dhe klikoni butonin Përdor



PËRDOR

Hapi 3: Pasi të keni klikuar butonin Përdor, rivendosni kredencialet tuaja në e-Albania (NIPT/ID dhe Fjalëkalim)

Hapi 4:

Më pas do të dërgoheni automatikisht në llogarinë tuaj në e-Filing dhe do t'ju shfaqet forma përkatëse për ndryshimin e fjalëkalimit ku do të keni mundësinë të kryeni ndryshimet

Shënim:

- Nëse tatimpaguesi/individit nuk është i regjistruar në sistemin e administratës tatimore e-Filing, logimi nuk do të jetë i mundur dhe një mesazh gabimi do të shfaqet në ndërfaqe: **“Ju nuk jeni i regjistruar si tatimpagues. Ju lutem regjistrohuni më parë!”**
- Nëse tatimpaguesi/individit nuk është i regjistruar në sistemin e-Albania, logimi dhe ndryshimi i fjalëkalimit nuk do të jetë i mundur dhe një mesazh gabimi do të shfaqet në e-Albania: **“Identifikimi në portal nuk u krye. Ju lutemi vendosni saktë kodin e përdoruesit dhe fjalëkalimin, ose aktivizoni profilin tuaj duke klikuar në linkun e ardhur në email.”**